

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A- 066/15**

**Prishtinë,  
7 dhjetor 2016**

Në çështjen juridike të:

**R.M.**

**Pala ankuese**

**kundër**

**Nuk ka**

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA39565), i datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur në 7 dhjetor 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Hidhet poshtë si e pasafatshme ankesa e R. M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013, i datës 27 nëntor 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA39565.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 5 maj 2007, R. M, (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) ku ka kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore ndaj ngastrës kadastrale nr. 377, me kulturë mal dhe me sipërfaqe prej 03.11.19 ha, që ndodhet në Komunën e Istogut (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Në vazhdim pala ankuese kërkon kompensimin për shfrytëzimin e pronës së kërkuar pa pëlqimin e tij.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij ai ka dorëzuar në AKP, këto dokumente:
  - Aktgjykimin Nr. 246/92, të lëshuar nga Gjykata Komonale në Istog, më 23 tetor 1996, përmes së cilit shpallet e pavlefshme kontrata e shkëmbimit nr. 86/60, e lidhur më 13 dhjetor 1960 në mes të M, R, K, S, I, R dhe S M dhe Komunës së Istogut, në lidhje me ngastrën kadastrale nr. 377 me sipërfaqe prej 03.11.19, që ndodhet në Fletën Poseduese nr. 234.
3. Identifikimi fizik i kërkesës është bërë më 26 dhjetor 2008, dhe paraqet pronën e kërkuar si mal i cili nuk është i uzurpuar.
4. Kërkesa mbetet e pakontestuar sepse askush nuk ka shprehur interesim të marrë pjesë në procedurë, brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, sipas nenit 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079.
5. Sipas raportit të verifikimit të datës 22 prill 2009; Aktgjykimi nr.246/92 nuk është gjetur, ndërsa sa i përket pronës së kërkuar, ajo është gjetur e regjistruar si pronë shoqërore NB “Dubrava” Istog.
6. Më 21 tetor 2013 dhe 1 nëntor 2013, pala ankuese është kontaktuar nga AKP-ja me telefon dhe ai e ka konfirmuar se ai dhe familja e tij nuk e kishin në posedim pronën e kërkuar qysh nga viti 1960, kur prona i ishte shitur Komunës së Istogut dhe humbja e posedimit nuk ishte e ndërlidhur me konfliktin. (faqe nr. 052 e dosjes së lëndës).
7. Më 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës e ka hedhur poshtë kërkesën me vendimin e vërtetuar KPCC/D/A/220/2013. Në paragrafin 18 të vendimit, i cili i referohet posaçërisht kërkesës, thuhet se në bazë të dokumentit të dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës dhe të verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, paraqitësi i kërkesës nuk ka treguar se kërkesa përfshinë rrethana të ndërlidhura drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti gjatë viteve 1998-

1999. Për sa i përket kompensimit për dëmin fizik, apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar, Komisioni nuk ka juridiksion ndaj kërkesës së tillë, në bazë të Ligjit nr. 03/L-079.

8. Më 5 maj 2014, vendimi i është dorëzuar palës ankuese. Ai e ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së më 14 tetor 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese deklaroi se vendimi i lëshuar nga KKPK-ja është i bazuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
10. Pala ankuese pohon se ankesa e tij duhet të merret parasysh pasi ai për arsye shëndetësore nuk ishte në gjendje ta paraqiste ankesën brenda afatit.

### **Arsyetimi ligjor:**

11. Ankesa është e pasafatshme. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh si në vijim: *“brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.
12. Palës ankuese i është bërë dorëzimi më 5 maj 2014. Afati kohor ka përfunduar më 4 qershor 2014. Megjithatë, pala ankuese e ka paraqitur ankesën e tij vetëm më 14 tetor 2014. Që është jashtë afatit. Përveç pretendimit se ai kishte probleme shëndetësore, ai nuk ka ofruar asnjë arsyetim dhe gjykata nuk ka mundur të zbulojë asnjë arsye për vonesë. Nuk është dorëzuar asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij se kishte probleme shëndetësore.
13. Prandaj ankesa duhet të hidhet poshtë në baza procedurale si e pasafatshme në pajtim me (nenin 13.3 nën-paragrafi (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), nenin 195.1 (a) dhe nenin 196 të LPK-së.

### **Këshillë juridike**

14. Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, gjyqtar

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it